



UNË



ZGJEDH

HISTORIA DHE ZHVILLIMI I DEMOKRACISË

ALTONA (13), ANESA (12), IBRAHIM (13), ANDIN (12), KALTRINA (13)



Në këtë artikull mund të lexoni disa fakte që kemi shkruajtur për demokracinë dhe historinë e saj. Ne ju urojmë lexim të mbarë

Disa herë kur kemi qenë të vegjël, nuk kemi ditur cilën lojë ta luajmë. Të luajmë fshehtazi, futboll, voleyboll apo lojëra të tjera? Pasi që kemi marrë vendimin të zgjedhim së bashku, ne kemi votuar. Cila lojë ka pasur më shumë vota, ne e kemi luajtur atë lojë. Kjo do të



thotë se shumica ka vendosur dhe të tjerët janë pajtuar me atë vendim. Kjo mënyrë e vendimmarrjes është një formë e demokracisë. Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre. Ne sot në Punëtorinë e Demokracisë kemi mësuar pikërisht për demokracinë. Ajo rrjedh nga fjalët greke, që në gjuhën shqipe „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ qeverisje. Pra, shohim se demokracia është qeverisje e popullit. Kjo formë e





qeverisjes ka lindur për herë të parë në Athinë në vitin 507 p.e.s. Forma e parë e demokracisë është quajtur demokraci direkte apo e drejtpërdrejtë, në të cilën ka udhëhequr i gjithë populli. Gratë, të varfërit, personat nën moshën 18 vjeçare dhe personat e moshuar nuk kanë pasur të drejtë të bashkangjiten në vendimmarrje. Sot, demokracia ekziston në shumicën e shteteve të botës. Megjithatë, Gjermania në kohën e Hitlerit nuk ka pasur demokraci, por ka pasur diktaturë. Diktatori ka udhëhequr përmes urdhërave. Njerëzit, të cilët punonin për të është dashur me patjetër ta dëgjojnë dhe të respektojnë urdhërat e tij. Kjo është e kundërta e demokracisë. Në Kosovë kemi demokraci të drejtë dhe të plotë, dhe ajo quhet demokraci përfaqësuese. Në këtë lloj të demokracisë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare votojnë për përfaqësuesit e tyre. Ne mendojmë që demokracia duhet të zhvillohet në të gjithë botën e jo vetëm në disa shtete.




Gazetarët e këtij artikulli

ZGJEDHJET DHE KUSHTET E VOTIMIT

LAURETA (13), SHPRESIM (13), SHKËLQIM (12), YLLKA (12), LEART (12)


-  Partia e kuqe
-  Partia e kaltër
-  Partia e kaltër1
-  Partia rozë



Ne mendojmë që demokracia është formë e mirë e qeverisjes. Në demokraci, të gjithë jemi të barabartë dhe kemi mundësi zgjedhjesh të ndryshme

Demokracia është një formë e qeverisjes, ku populli e ka fjalën kryesore. Një ndër elementet kryesore në demokraci përveç të tjerash, janë edhe zgjedhjet.

Në jetën e përditshme ne bëjmë zgjedhje të ndryshme. Për shembull, ne zgjedhim kryetarin e klasës. Mirëpo,



ne akoma nuk mund të zgjedhim kryetarin e komunës ose deputetët. Kjo sepse ende nuk i kemi mbushur 18 vjet. Do të thotë, sipas ligjit, në procesin zgjedhor kanë të drejtë votimi personat mbi moshën 18 vjeçare. Mirëpo, pjesëmarrjen në zgjedhje nuk e pengon përkatësia fetare, racore apo etnike. Në Republikën e Kosovës ka zgjedhje lokale dhe qendrore. Zgjedhjet lokale janë ato ku qytetarët votojnë për të zgjedhur kryetarin e komunës. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për kandidatët për deputetë. Pasi që

të bëhet numërimi i votave, atëherë zgjedhen deputetët të cilët kanë marrë më së shumti vota. Këta deputetë, me miratimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fillojnë të punojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ata zyrtarisht janë përfaqësues të popullit. Mbi supet e tyre tani ata mbajnë përgjegjësi të madhe. Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë. Këta deputetë zgjedhen nga populli, me qëllim të përmirësimit të jetës tonë. Të gjithë deputetët janë kosovarë. Por, iu përkasin etnive të ndryshme, si: shqiptarë, serbë, ashkalinjë, romë, egjiptianë, turq, etj.

Pra, 100 deputetë janë të komunitetit shqiptar, kurse 20 iu përkasin komuniteteve të tjera. Deputetët bëjnë punë shumë të rëndësishme dhe gjithnjë mendojnë për shtetin e tyre. Prandaj, duhet t'i respektojmë ata.



Autorët e artikullit



Forma më e mirë e qeverisjes



Shkëlqimi duke i ndihmuar Shpresimit




E drejta e strehimit duke u treguar përmes aktiviteteve



Yllka dhe Laureta duke punuar për artikullin



Krenari duke bashkëpunuar me Gentianin



Ndihemi me fat që jemi gazetarë



Anesa dhe Kaltrina kontribuojnë për artikullin me vizatime



Andini duket dëgjuar njërin prej kolegëve të tij gazetar

NE I UJISIM ME VOTA, ATA BËJNË LIGJE PËR NE

ALTIN (13), ARTINA (13), KRENAR (13), GENTIAN (12), REA (13)



Ne nxënësit e klasës së VII-të, për ju të dashur lexues kemi përgatitur një artikull me plot informata rreth Kuvendit dhe punën që e bën ky institucion

Faleminderit që keni zgjedhur artikullin tonë për t'u informuar më shumë për punën që bën Kuvendi. Arsyeja pse vendosëm të shkruajmë për këtë institucion është fakti se ndikimi i tij në jetën tonë është shumë i madh. Nëse nuk do të ishte i pranishëm në jetërat tona, atëherë ato nuk do të ishin ashtu siç janë sot. A thua si është e mundur kjo gjë, që një institucion të ketë rol dhe ndikim kaq të madh? Ne, me dëshirën më të madhe do t'iu tregojmë.

Sot, ne e gëzojmë të drejtën e arsimit. Falë këtij institucioni, ne sot jetojmë në një vend ku e drejta e fjalës është një ndër të drejtat themelore e që respektohet nga të gjithë. Madje, edhe prania jonë sot në këtë Punëtori është meritë e këtij institucioni. E shumë të mira të tjera Kuvendi ka bërë, për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Të gjitha këto që i cekëm më lart, mundësohen nga ligjet të cilat miratohen në Kuvend. Për shembull, ligjet për arsim burojnë nga ky institucion. Për këtë ne jemi shumë falendërues ndaj Kuvendit. Kjo jo vetëm që është në të mirën tonë si nxënës, por po ashtu është edhe në të mirën e vendit tonë. Kur ne jemi të arsimuar, pa dyshim që edhe e ardhmja e vendit tonë është shumë më e ndritur. E, që të arrihet e tërë kjo

përkujdeset Kuvendi, më saktësisht deputetët që ne i zgjedhim. Kur themi ne, mendojmë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. E drejta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, shfrytëzohet pas kësaj moshe.

Qytetarët e Republikës së Kosovës përfaqësohen nga 120 deputetë. Këta deputetë punojnë në Kuvend. Kuvendi ka disa funksione, siç janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe ai kontrollues. Këto janë tri funksionet kryesore të këtij institucioni. Mirëpo, përpos këtyre funksioneve, Kuvendi bën edhe miratimin e buxhetit. Po ashtu, bën edhe zgjedhjen e Presidentit. Ligjet që miratohen ndikojnë tek ne. Mirëpo, që ato ligje të zbatohen, duhet të kujdeset Qeveria. Për këtë arsye Kuvendi e kontrollon punën e Qeverisë. Ndërkaq, e fundit fare është që nevojat tona dhe interesat tona duhet të dëgjohen, e për këtë Kuvendi e bën përfaqësimin e popullit.



Gazetarët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidemi“
Klasa: VII-1
Vendi: Pozharan, Viti